



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 30.03.2026


PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“INFRASTRUKTURA “REHABILITIMI I INFRASTRUKTURËS SË AEROPORTIT,
PËRFSHIRË PISTËN, RRUGËT LIDHËSE DHE VENDET E PARKIMIT, PËR TË
AKOMODUAR AVION TË KODIT E”, ME VENDNDODHJE BRENDA TERRITORIT TË
AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, BASHKIA KRUIË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Tirana International Airoport” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:


1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Infrastruktura “Rehabilitimi i infrastrukturës së Aeroportit, përfshirë pistën, rrugët lidhëse dhe vendet e parkimit, për të akomoduar Avion të kodit E”, me vendndodhje brenda territorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës”, Bashkia Krujë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Tirana International Airoport” sh.p.k, miratuar me Vendimin Nr. 29, datë 18.10.2023 të Këshillit Kombëtar të Territorit (sot KKTU).
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



Nënshkruar më datë 21/04/2026